

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR (ICMP)”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

Kjo marrëveshje synon intensifikimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri midis datave 29 nëntor 1944 dhe 2 korrik 1991, duke përcaktuar në veçanti rregullat e bashkëpunimit për identifikimin, gjetjen e personave të zhdukur, si dhe për koordinimin e punës me organet kompetente.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është planifikuar në programin analitik të projektakteve për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje lidhen me nevojën e gjetjes së personave të zhdukur, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit për këtë qëllim.

Në veçanti, palët do të ndërmarrin masa të përbashkëta, duke bërë të mundur gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste. Gjithashtu, pritet që palët, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje, të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me problematikat që mund të lindin gjatë zbatimit të saj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI (VENDAS E NDËRKOMBËTAR)

Projektligji është hartuar në përputhje me neneve 78, 83 e 155 të Kushtetutës, si dhe është në harmoni me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Sipas parashikimeve të marrëveshjes, ICMP-ja do të krijojë një zyrë shërbimi për gjetjen e personave të zhdukur, duke përdorur metoda tekniko-shkencore të zbulimit e të identifikimit, si dhe shkëmbimin e informacionit me organet kompetente në kuadër të koordinimit të bashkëpunimit, me qëllim realizimin e aktivitetit administrativ.

Zyra e ICMP-së do të themelohet në Tiranë, në kryeqytetin e Shqipërisë. ICMP-ja do të jetë përgjegjëse financiarisht për ambientet, pajisjet dhe orenditë për përmbushjen efektive të funksioneve të saj.

ICMP-ja do të gëzojë imunitetet dhe privilegjet e garantuara për të gjitha misionet diplomatike të akredituara në Shqipëri, në përputhje me Konventën e Vjenës.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje dhe në dokumentet e rregulloret e ICMP-së dhe të personelit, të shpallura në lidhje me kushtet e punësimit të zyrtarëve, në ambiente do të zbatohen ligjet dhe rregulloret e Shqipërisë. ICMP-ja do të informojë menjëherë autoritetet shqiptare për çdo rregullore e rregull ekzistues dhe do të këshillojë Shqipërinë menjëherë për çdo rregullore dhe rregulla të miratuara rishtazi.

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, ICMP-ja mund të punësojë ekspertë të huaj, por edhe ata me shtetësi shqiptare. ICMP-ja merr përsipër trajnimin e ekspertëve, ku mund të organizojnë trajnime të përbashkëta, nëse është e nevojshme. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin e tyre, autoritetet kompetente të palëve mund të shkëmbejnë ekspertizë nëpërmjet zyrës, lidhur me çështjet e parashtruara në këtë marrëveshje, me qëllim thjeshtësimin dhe harmonizimin e procedurave e të praktikave.

Shkëmbimi i përbashkët i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve do të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës dhe atë ndërkombëtar. Shkëmbimi dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar do të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar e atë ndërkombëtar.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi kur Këshilli i Ministrave të njoftojë ICMP-në se janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe ku ICMP-ja t'i konfirmojë Këshillit të Ministrave marrjen e njoftimit.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të zyrës është e parashikuar në tërësi në tekstin e marrëveshjes. Krijimi i kësaj zyre nuk do të sjellë mbivendosje me organet e zbatimit të ligjit, pasi qëllimi është rritja dhe forcimi i bashkëpunimit të autoriteteve kompetente të palëve, nëpërmjet evidentimit, gjetjes së personave të zhdukur, shkëmbimit të informacionit, duke përcaktuar mirë detyrat e zyrës, të pavarura nga detyrat e organeve të administratës publike.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Autoritetet kompetente do të jenë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes është hartuar nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

ICMP-ja do të gëzojë imunitetet dhe privilegjet e garantuara për të gjitha misionet si dhe ICMP-ja do të përjashtohet nga tarifat dhe taksat, në përputhje me Konventën e Vjenës.

KËSHILLI I MINISTRAVE